



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 223/6 prot.

Shkodër, më 10.09. 2026

NJOFTIM

**Për ndryshimin e orarit të seancave të këshillimit me publikun në Njësinë Administrative
Bërdicë**

Në vijim të njoftimeve të Këshillit Bashkiak Shkodër, për zhvillimin e proceseve të këshillimit me publikun, konkretisht:

- për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 dhe projektbuxhetin vjetor 2027 të Bashkisë Shkodër;
- për projektligjin “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”;

dhe në kushtet kur në datën 17.09.2026 është planifikuar gjithashtu zhvillimi i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në orën 17:00, ju bëjmë me dije se ndryshojnë vetëm oraret e seancave të këshillimit me publikun të planifikuara për këtë datë në Njësinë Administrative Bërdicë.

Seancat do të zhvillohen si më poshtë:

- Këshillimi me publikun për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 dhe projektbuxhetin vjetor 2027, i planifikuar në orën 15:00, **do të zhvillohet në orën 13:00;**
- Këshillimi me publikun në kuadër të procesit të reformës administrativo-territoriale, i planifikuar në orën 16:00, **do të zhvillohet në orën 14:00.**

Data dhe vendi i zhvillimit të seancave mbeten të pandryshuara:

Datë: 17.09.2026

Vendi: Njësia Administrative Bërdicë, Shkolla “Agim Tafili”

Ju falënderojmë për mirëkuptimin.

SEKRETARE

Sabina Danaj

